

# Ndërhyrjet e Palëve të Treta Para Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut

---

**Udhëzues për  
Institucionet Kombëtare  
të të Drejtave të Njeriut**

Tetor 2020



## Përmbajtja

Parathënie .....	3
Hyrje .....	4
Mandati i NHRI-ve për të ndërhyrë në cilësinë e palëve të treta para GJEDNJ .....	5
1.1 Parimet e Parisit dhe Rregullorja Themeluese e NHRI.....	5
1.2 Kuadri Rregullativ i GJEDNJ-së.....	6
Pse NHRI-të duhet të ndërhyjnë në cilësinë e palëve të treta para GJEDNJ? .....	7
2.1 Rëndësia e ndërhyrjeve të palëve të treta për GJEDNJ.....	7
2.2 Rëndësia e ndërhyrjeve të palëve të treta nga dhe për NHRI-të .....	9
Si mund të ndërhyjnë NHRI-të në GJEDNJ? .....	14
3.1 Identifikimi i rasteve të përshtatshme.....	14
3.2 Kërkesa për leje (Rregulli 44).....	15
3.3 Udhëzime për mënyrën e të shkruarit të ndërhyrjes së Palës së Tretë.....	17
3.4 Komunikimi me Sekretarin e Gjykatës .....	22
Pas paraqitjes së kërkesës për ndërhyrjeje të Palës së Tretë .....	23

## Parathënie

### Robert Spano, Kryetar i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Kam kënaqësinë të paraqes parathënien e këtij udhëzuesi tepër të dobishëm të hartuar nga Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI), i cili synon të mbështesë dhe forcojë punën e institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut në paraqitjet e tyre si palë të treta pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Sikurse pranohet gjerësisht, sukcesi i sistemit të Konventës arrihet përmes një kombinimi të përpjekjeve në nivel qeveritar, parlamentar, gjyqësor si dhe në nivelin e institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut dhe të shoqërisë civile. Institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut mund të luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin efektiv të Konventës falë pozicionimit të tyre unik si një urë midis shtetit dhe shoqërisë civile. Ky udhëzues përqendrohet në një fushë të veçantë veprimi, në paraqitjet e palëve të treta para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila është pjesë e një fushe më të gjerë interesi, procesit strategjik gjyqësor. strategic litigation.

Paraqitjet e palëve të treta pranë Gjykatës përbëjnë një formë përmes së cilës Shtetet Palë, organizatat e tjera ndërkombëtare, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe shoqëria civile mund të angazhohen në mënyrë aktive në dialog me Gjykatën. Sikurse vetë Shtetet Palë kanë theksuar në Deklaratën e Kopenhagën-it të vitit 2018, kjo mënyrë ka efektin e forcimit të autoritetit dhe legjitimitetit të Gjykatës si dhe të përmirësimit të efektivitetit të të gjithë sistemit. Ndërhyrjet e palëve të treta nga ENNHRI ose institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut mund të ofrojnë perspektiva të ndryshme për Gjykatën: kuadrin ligjor dhe praktikën në nivelin kombëtar të një shteti të veçantë; të dhëna dhe statistika nga terreni; përmbledhje krahasuese të praktikave vendase të Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës; analizë të jurisprudencës ndërkombëtare mbi çështjen në fjalë ose mbi praktikën gjyqësore të vetë Gjykatës.

Vlera e shtuar e këtij udhëzuesi gjithëpërfshirës është ofrimi i këshillave praktike dhe i burimeve mbi arsyet, kohën dhe mënyrën se si të përgatiten paraqitjet e një pale të tretë, përfshirë këtu një seksion shumë të dobishëm me gjëra që duhen dhe nuk duhen bërë, si dhe shumë shembuj të paraqitjeve të rasteve konkrete.

Së fundmi, do të doja të falënderoja të gjitha institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, si dhe vetë Rrjetin Evropian të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI) për ndërhyrjet individuale e kolektive. Unë e di që përgatitja dhe shkrimi i ndërhyrjeve të palëve të treta është një punë me intensitet të lartë që mund të marrë shumë nga koha juaj. Ndonjëherë mund të pyesni veten se çfarë ndikimi kanë ato. Në emër të Gjykatës, mund t'ju siguroj që të gjitha paraqitjet lexohen me interes dhe kujdes dhe se në varësi të çështjes, ato mund të luajnë një rol shumë të dobishëm në vendimmarrjen tonë.

Robert Spano  
Strasburg, 17 shtator 2020

## Hyrje

Ky botim e ka origjinën nga një sesion trajnimi të zhvilluar me kërkesën e Institucioneve Kombëtare të Drejtave të Njeriut (NHRI), të cilat janë aktive në Grupin e punës për çështjet Ligjore të ENNHRI-t, në lidhje me hartimin dhe drejtimin në mënyrë kuptimplote të ndërhyrjeve të ekspertëve të palëve të treta përpara Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Trajnimi u përqëndrua në Ndërhyrjet e Palës së Tretë të NHRI-ve para GJEDNJ, duke përfshirë si çështjet gjyqësore individuale strategjike të NHRI-ve ashtu dhe çështjet kolektive strategjike të ENNHRI-t, të cilat përbëjnë një nga funksionet kryesore të Grupit të Punës për Çështjet Ligjore të ENNHRI. Trajnimi për NHRI-të përfitoi nga ekspertiza e ofruar nga Sekretaria e GJEDNJ dhe Nisma për Drejtësi e Shoqërisë së Hapur.

Ndërhyrjet e Palëve të Treta janë një mjet i rëndësishëm për çdo proces gjyqësor strategjik, veçanërisht në nivel Evropian. NHRI-t dhe ENNHRI mund të paraqiten para GJEDNJ si palë neutrale në raste të caktuara, duke siguruar ekspertizë mbi çështjet e të drejtave të njeriut të cilat palët nuk mund t'i paraqesin para Gjykatës dhe, në veçanti, për të siguruar analizë standardeve dhe zhvillimeve që mund të nxirren nga ligji dhe praktika, përtej KEDNJ<sup>1</sup>. Roli thelbësor që NHRI-të mund të luajnë në zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) në nivel kombëtar u njoh nga Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës në Deklaratën e Kopenhagenit të vitit 2018<sup>2</sup>, duke theksuar rëndësinë e ndërhyrjeve të palëve të treta para GJEDNJ.

Qëllimi i këtij dokumenti është të përmbledhë informacionin e nevojshëm dhe ta bëjë atë të disponueshëm për NHRI-të që ndërhyjnë në cilësinë e palës së tretë, si një burim për t'i mbështetur ato në aktivitetet e tyre të avokatisë dhe veprimtarive gjyqësore.

Për çështje të qartësisë, ky udhëzues përdor termin Ndërhyrje të Palës së Tretë ose Palë të Tretë. Termi '*amicus curiae*' nuk do të përdoret sepse ka një kuptim tjetër në Mbretërinë e Bashkuar ndryshe nga SH.B.A. dhe gjetkë, ku është bërë një term i vendosur për Palën e Tretë<sup>3</sup>.

---

<sup>1</sup> Ndërsa pranon që interpretimi i Konventës është një prerogativë e vetë GJEDNJ, Komiteti Drejtues i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut (CDDH) vuri në dukje se një interpretim i Konventës që është në kundërshtim me instrumentet e tjerë të së drejtës ndërkombëtare publike (të tilla si ligji humanitar) mund të ketë një efekt të dëmshëm mbi autoritetin e praktikës gjyqësore të GJEDNJ dhe efektivitetin e sistemit të Konventës në tërësi.

<sup>2</sup> [Copenhagen Declaration](#) (2018) p.2, 14

<sup>3</sup> Nga vitet 1600 në Mbretërinë e Bashkuar, *amicus curiae* (që në ditët e sotme referohet si 'avokat i gjykatës') mbetet një figurë kryesisht e paanshme, e emëruar nga *Attorney General* me kërkesë të gjykatës.

# Mandati i NHRI-ve për të ndërhyrë në cilësinë e palëve të treta para GJEDNJ

## 1.1 Parimet e Parisit dhe Rregullorja Themeluese e NHRI

Parimet e Parisit theksojnë rolin e NHRI-ve për të bashkëpunuar me institucionet ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare që janë kompetente në fushat e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut.

3. Një institucion kombëtar, ndër të tjera, do të ketë përgjegjësitë e mëposhtme:

(e) Të bashkëpunojë me Kombet e Bashkuara dhe çdo organizatë tjetër në sistemin e Kombeve të Bashkuara, institucionet rajonale dhe institucionet kombëtare të vendeve të tjera që janë kompetente në fushat e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut;

Në Evropë, angazhimi i NHRI-ve me GJEDNJ, përfshirë përmes Ndërhyrjeve si Palë të Treta, është një rrugëtim i rëndësishëm për NHRI-të në përmbushje të rolit të tyre. Rregullorja themeluese e një NHRI mund të përfshijë kompetencën për të ndërhyrë si Palë e Tretë përpara gjykatave kombëtare, rajonale dhe / ose ndërkombëtare në çështjet që lidhen me dispozitat kushtetuese dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

### **NHRI-të në Fokus: Komisioni i Barazisë dhe të Drejtave të Njeriut (EHRC), Britania e Madhe**

Ndër kompetencat ligjore të EHRC është mandati për të ndërhyrë në procedurat gjyqësore. Kjo është përcaktuar në s30 (1) Akti i Barazisë 2006, ku parashikohet se:

*Komisioni mund të fillojë ose të ndërhyjë në procedurat gjyqësore, për rishikim gjyqësor ose ndryshe, nëse Komisioni vlerëson se procedurat janë të rëndësishme për një çështje që lidhet me funksionet e Komisionit."*

Komisioni gjithashtu ka fuqi unike për të filluar ose ndërhyrë në procedurat e rishikimit gjyqësor në lidhje me të drejtat e njeriut, pa qenë viktimë e një veprimi të paligjshëm.

Gjithashtu, si kolektiv, NHRI-të në Evropë kanë ndërhyrë si Palë të Treta para GJEDNJ-së. Ndërhyrja e parë kolektive daton në vitin 2008, kur Grupi Evropian i NHRI-ve ndërhyri në D.D. v. Lituania, në një çështje lidhur me zotësinë juridike të personave me aftësi të kufizuar. Deri më sot, ENNHRI ka paraqitur pesë ndërhyrje në GJEDNJ, në raste që kanë të bëjnë me një larmi shqetësimesh rajonale për të drejtat e njeriut<sup>4</sup>. Përmes Grupit të tij të Punës për Çështjet Ligjore, ENNHRI ka zhvilluar një procedurë të përbashkët për Ndërhyrjet e Palëve të Treta para GJEDNJ (më tej nën 2.2). Sipas kësaj Procedure, anëtarët e Grupit të Punës për Çështjet Ligjore dakortësuan të monitorojnë rastet që lidhen me shtetin e tyre.

<sup>4</sup> [Strøbye v. Denmark and Rosenlind v. Denmark](#) (Apps. Nos. 25802/18 and 27338/18); [Big Brother Watch v United Kingdom](#) (App No. 58170/13); [Ten Human Rights Organisations v. United Kingdom](#) (App No. 24960/15); [Gauer and others v. France](#) (App No. 61521/08); [D.D. v. Lithuania](#) (pranimi kundër dëshirës në një institucion të shëndetit mendor dhe parregullsitë në procedurat e kujdestarisë) (App No. 13469/06).

## 1.2 Kuadri Rregullativ i GJEDNJ-së

Në nivelin rajonal, dy dispozita rregullojnë ndërhyrjet e palëve të treta para GJEDNJ: neni 36 i KEDNJ dhe rregulli 44 i [rregullores së gjykatës](#).

### **NENI 36**

#### *Ndërhyrja e palës së tretë*

1. Në të gjitha çështjet para një Dhome ose Dhomës së Madhe, një Palë e Lartë Kontraktuese, shtetasi i së cilës është kërkues, ka të drejtë të paraqesë komente me shkrim dhe të marrë pjesë në seancë gjyqësore.
2. Kryetari i Gjykatës, në interes të administrimit të rregullt të drejtësisë, mund të ftojë çdo Palë Kontraktuese që nuk është palë në gjykim ose një person të interesuar që nuk është kërkues të paraqesë komente me shkrim ose të marrë pjesë në seanca.
3. Komisioneri për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës mund të paraqesë komente me shkrim dhe të marrë pjesë në seanca në të gjitha çështjet para një Dhome ose Dhomës së Madhe.

### **RREGULLI 44**

3. (a) Sapo njoftimi për një kërkesë t'i jetë dhënë Palës Kontraktuese të paditur sipas Rregullave 51 § 1 ose 54 § 2 (b), Kryetari i Dhomës , në interes të administrimit të duhur të drejtësisë, siç parashikohet në Nenin 36 § 2 të Konventës, mund të ftojë ose të autorizojë çdo Palë Kontraktuese që nuk është palë në proces, ose çdo person të interesuar i cili nuk është aplikant, të paraqesë komente me shkrim ose, në raste të jashtëzakonshme, të marrë pjesë në një seancë dëgjimore.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut parashikon mundësitë e mëposhtme për ndërhyrjet e palëve të treta:

- a) Neni 36 (2) i KEDNJ-së i mundëson Kryetarit të Gjykatës që të ftojë Palët e Treta të paraqesin komente me shkrim ose të marrin pjesë në seanca dëgjimore.
- b) Rregulli 44 (3), i siguron Palëve të Treta mundësinë për të aplikuar për të ndërhyrë me iniciativën e tyre. Rregulli 44 (3) ka qenë baza procedurale e përdorur për ndërhyrjet individuale dhe kolektive të Palës së Tretë të NHRI-ve para GJEDNJ deri më sot.

Siç do të detajohet në vijim, hapësirat për të ndërhyrë si Palë e Tretë janë të pakta, ndaj për NHRI-të mund të jetë sfiduese ndërhyrja drejtpërdrejt para GJEDNJ-së. Në këto kushte, për NHRI-të mund të jetë interesante paraqitja e informacionit në mënyrë indirekte:

- Përmes ndarjes së mendimeve dhe informacioneve me aktorë të tjerë që marrin pjesë në procedurat e Gjykatës. Për shembull, në përputhje me nenin 36 (3) të KEDNJ-së, Komisioneri i Këshillit të Evropës (KiE) për të Drejtat e Njeriut, nëse ajo/ai dëshiron mund të ndërhyjë në rastet para një Dhome ose Dhomës së

Madhe pa nevojën e kërkimit të lejes dhe NHRI-të kanë mundësinë t'i sigurojnë Komisionerit informacionin përkatës. ENNHRI gëzon bashkëpunim të ngushtë me Komisioneren e KiE e cila mbështet NHRI-të në punën e tyre në nivel kombëtar dhe rajonal dhe merr në konsideratë informacionin e NHRI-ve në punën e saj .

- Përmes njërës nga palët (zakonisht aplikuesi). Kjo është e mundur, për shembull, duke lëshuar një mendim të specializuar në mbështetje të pozicionit të palës. Ky opsion është përdorur deri më tani nga OJF-të, megjithatë NHRI-të mund të vendosin të përdorin edhe këtë metodë.

## **Pse NHRI-të duhet të ndërhyjnë në cilësinë e palëve të treta para GJEDNJ?**

### **2.1 Rëndësia e ndërhyrjeve të palëve të treta për GJEDNJ**

Rregullorja e Procedurave të GJEDNJ tregon se arsyetimi për ndërhyrjet e Palëve të Treta qëndron në "interesin e administrimit të duhur të drejtësisë". GJEDNJ merret me çështje me rëndësi të madhe publike dhe ndikimi i vendimeve të saj është shumë i gjerë. Duke pasur parasysh natyrën kontradiktore të procedurave ligjore, Gjykata kryesisht mbështetet në informacionin e siguruar nga palët, i cili jo gjithmonë mund të trajtojë të gjitha çështjet thelbësore dhe argumentet ligjore në lidhje me atë çështje individuale. Për më tepër, palëve mund t'u mungojë një bazë e mjaftueshme e provave, të tilla si informacionet e lidhura me çështjen dhe statistikat të përditësuara, për të mbështetur çështjen e tyre. Prandaj, GJEDNJ mirëpret ndërhyrjet e palëve të treta për të pasuruar diskutimet e saj dhe i bashkëngjit kontekstin gjyqimor të saj. Ndërhyrjet e Palëve të Treta konsiderohen si një veçori e konsoliduar e çështjeve para GJEDNJ, veçanërisht në procedurat para Dhomës së Madhe.

Pjesëmarrja e Palëve të Treta shihet si një formë e dialogut: e domosdoshme dhe konstruktive. Ndërhyrjet e palëve të treta janë veçanërisht të dobishme nëse GJEDNJ dëshiron të vendosë nëse ekziston një konsensus evropian ose ndërkombëtar për një çështje të veçantë. Për më tepër, Ndërhyrjet e Palëve të Treta mund të frymëzohen nga praktika gjyqësore, përtej asaj të GJEDNJ, dhe të tregojnë se si juridiksionet e tjera trajtojnë një çështje ose koncept të veçantë. Ndërhyrjet e Palëve të Treta gjithashtu mund të ilustrojnë interesa të ndryshëm në rrezik në një rast të veçantë dhe prevalencën e disa çështjeve mbi të tjerat.

Pesha e autoritetit të dhënë të ndërhyrjeve të palëve të treta varet rast pas rasti dhe nuk bëhet e qartë nga GJEDNJ. Teksa në gjyqim përmendet nëse për çështjen në fjalë është paraqitur ndërhyrje, nuk ka shumë raste kur pranohet në mënyrë eksplicite, që një ndërhyrje specifike është përdorur ose ka pasur një ndikim të veçantë.

Megjithatë, Ndërhyrjet e Palëve të Treta përbëjnë një pjesë integrale të trajtimit të çështjeve dhe, si një premisë, merren parasysh siç duhet nga Dhomat e Gjykatës.

**NHRI-të në Fokus: Parashtrimet e përbashkëta të NHRI-së së Irlandës Veriore (NIHRC) dhe NHRI-së së Britanisë së Madhe (EHRC), përmendur në gjykimin e GJEDNJ.**

Gjykata përfshiu një referencë për paraqitjen e përbashkët të NHRI-së së Irlandës së Veriut (NIHRC) dhe NHRI-së së Britanisë së Madhe (EHRC) në gjykimin e çështjes *McCaughey & Others v. Mbretëria e Bashkuar*<sup>5</sup>. Çështja kishte të bënte me vrasjen e Martin McCaughey dhe Dessie Grew nga ushtarët britanikë në tetor 1990.

### **Në paraqitje, NHRI-të pretenduan se:**

Testi i provës standarde për procedimin penal në Mbretërinë e Bashkuar nuk arrin të përmbushë në mënyrën e duhur detyrimin pozitiv të Shtetit për të realizuar procedimin penal në rastet e parashikuara nga nenit 2;

Nevoja për një provë dëshmie më të ulët në rastet e nenit 2 përforcohet nga fakti që ligji i vetëmbrojtjes në legjislacionin anglez është formuluar në mënyrë shumë të gjerë, është pjesërisht subjektiv në formulimin e tij dhe është në kundërshtim me kërkesat e nenit 2 (2); Zbatimi i testit të provës, i kombinuar me ligjin e vetëmbrojtjes jo në përputhje me nenin 2, ka sjellë që në praktikë në Mbretërinë e Bashkuar procedimi penal i zyrtarëve shtetërorë për shkaktimin e vdekjes të jetë jashtëzakonisht i rrallë;

Fusha e rishikimit nga gjykatat vendase të zbatimit të provës dëshmuese është shumë e kufizuar dhe nuk arrin të përmbushë kërkesat e rrepta procedurale të Nenit 2;

Aftësia për të filluar një ndjekje penale private nuk e heq shtetin nga detyrimi i tij pozitiv sipas nenit 2 dhe, në çdo rast, shteti mban një pushtet të pakufizuar për të marrë përsipër dhe për të ndaluar një ndjekje penale private.

Kjo ndërhyrje u përmend në vendimin e GJEDNJ, ku dhe u theksua se ndërhyrja kishte të bënte me një çështje që nuk ishte ngritur nga vetë palët.

### **NHRI-të në Fokus: Parashtrimet e ENNHRI në GJEDNJ si palë e tretë, referuar në konkluzionet e gjykimin**

Gjykata referoi parashtrimet e ENNHRI në konkluzionet e gjykimin për çështjen Big Brother Watch dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar<sup>6</sup>, në pritje të Dhomës së Madhe.

Çështja ka të bëjë me ndarjen e inteligjencës kombëtare dhe të drejtën për privatësi dhe ishte hera e parë që një çështje solli në vëmendjen e Dhomës së Madhe pyetjen nëse një regjim i ndarjes së inteligjencës ndërkombëtare është në përputhje me nenin 8 (e drejta për privatësi dhe jetën familjare) të KEDNJ.

Në parashtrimet e tij, ENNHRI solli shembuj nga vendet anëtare që tregojnë se natyra e bashkëpunimit ndërkombëtar të inteligjencës ka ndryshuar ndjeshëm, gjë që krijon sfida të reja për mbikëqyrje të pavarur dhe efektive të ndarjes së inteligjencës.

<sup>5</sup> [McCaughey & Others v. the UK](#) (App. no. 43098/09)

<sup>6</sup> [Big Brother Watch and Others v. the United Kingdom](#) (Apps. Nos. 58170/13, 62322/14 and 24960/15)



Parashtrimet ofruan një përmbledhje të rekomandimeve nga OKB dhe organet evropiane për të drejtave të njeriut dhe për procedurat e veçanta, si dhe praktikrat e mira nga organet kombëtare të mbikëqyrjes se si këto sfida mund të adresohen për të siguruar mbikëqyrje të fuqishme të pavarur dhe efektive të ndarjes së informacionit. Paraqitja e ENNHRI-t ishte rezultat i bashkëpunimit midis NHRI-ve nga Grupi i punës për Çështjet Ligjore të ENNHRI.

## 2.2 Rëndësia e ndërhyrjeve të palëve të treta nga dhe për NHRI-të

### A. Rëndësia e parashtrimeve nga NHRI-të

Ndërhyrjet e NHRI-ve në cilësinë e palëve të treta kanë peshë specifike sepse ato bazohen në mandatin zyrtar të NHRI-ve për të siguruar informacion në mënyrë të pavarur mbi situatën e të drejtave të njeriut në shtetin e tyre. Një ndërhyrje nga një NHRI, mund të vlerësohet si një tregues me rëndësi i interesit publik dhe mund të tërheqë vëmendjen e Qeverisë për çështjen në fjalë ose të rrisë profilin e çështjes.

**NHRI-të në fokus: NHRI-ja Gjeorgjiane (Zyra e Mbrojtësit Publik) paraqet informacion për situatën kombëtare të të drejtave të njeriut si një palë e tretë në GJEDNJ**

NHRI-ja Gjeorgjiane paraqiti informacion mbi situatën kombëtare të të drejtave të njeriut në çështjen *Rustavi 2 Broadcasting Company Ltd and Others v. Georgia*<sup>7</sup>, aktualisht e kërkuar për referim në Dhomën e Madhe. Çështja ka të bëjë me një mosmarrëveshje mbi pronësinë e aksioneve në një kompani të njohur transmetuese televizive.

Në paraqitjen e saj, NHRI-ja identifikoi dhe përshkroi sfidat lidhur me lirinë e shprehjes dhe mjedisin mediatik në Gjeorgji, si dhe mangësitë institucionale në sistemin kombëtar të drejtësisë. Thuhet se një NHRI mund të kontekstualizojë një çështje për GJEDNJ në mënyrë shumë më të gjerë sesa një aplikant individual dhe në mënyrë më të pavarur sesa shteti i paditur.<sup>8</sup>

NHRI-të mund t'i sigurojnë GJEDNJ informacione faktike nga terreni si dhe informacione strukturore në lidhje me legjislacionin dhe politikrat përkatëse kombëtare në vend. Me pjesëmarrjen e tyre në procedurat e GJEDNJ, NHRI-të mund të nxjerrin në pah para Gjykatës ndikimin e gjerë publik të çështjes.

**NHRI-të në Fokus: NHRI-ja Daneze (Instituti Danez i të Drejtave të Njeriut) paraqet informacion si Palë e Tretë në GJEDNJ për një çështje për të cilën nuk kishte pasur jurisprudencë të mëparshme**

<sup>7</sup> [Rustavi 2 Broadcasting Company Ltd. and Others v. Georgia](#) (App. No. 16812/17)

<sup>8</sup> Antoine Buyse in Wouters and Meuwissen (2013) 177.

NHRI-ja Daneze paraqiti informacion mbi situatën kombëtare të të drejtave të njeriut në çështjen M.A kundër Danimarkës<sup>9</sup>. Çështja ka të bëjë me refuzimin e një kërkesë për ribashkim familjar, pasi aplikanti nuk posedonte leje qëndrimi për të paktën tre vjet, siç kërkohet zakonisht nga ligji danez për personat me një status të mbrojtjes së përkohshme. Paraqitja e Palës së Tretë siguroi informacione kontekstuale, ndërsa për këtë çështje nuk kishte pasur jurisprudencë të mëparshme në GJEDNJ.

Parashtrimet e NHRI-ve mund t'i tregojnë GJEDNJ nëse një çështje individuale është pjesë e një problemi në një shkallë të gjerë dhe sistematike në një vend. Një analizë e tillë mund të jetë veçanërisht e dobishme për GJEDNJ në kontekstin e gjykimeve pilot kur GJEDNJ zgjedh një çështje midis shumë çështjeve të krahasueshme, vendos mbi meritat dhe më pas tregon masat e përgjithshme që duhen marrë nga shteti i paditur<sup>10</sup>. Paraqitjet e NHRI-ve gjithashtu mund të ndihmojnë GJEDNJ për të zhvilluar masa të përgjithshme që godasin thelbin e problemit përmes identifikimit të ligjeve dhe politikave kombëtare problematike duke garantuar ndryshimin.

## B. Rëndësia e parashtrimeve për NHRI- të: Procesi gjyqësor strategjik

Ndërhyrja e palës së tretë para GJEDNJ-së është një sipërmarrje teknike dhe e cila kërkon burime intensive. Prandaj, kur NHRI-të shqyrtojnë mundësinë e ndërhyrjes në cilësinë e palës së tretë, duhet të binden se ndërhyrja e tyre është me rëndësi strategjike dhe shkon përtej informacionit që palët në çështje (dhe ndërhyrësit e tjerë të mundshëm) do t'i japin GJEDNJ-së. Raste strategjike në të cilat mund të ndërhyjnë NHRI-të, për shembull, janë ato që përfshijnë çështje me rëndësi të gjerë publike dhe mund të kenë ndikim të madh në interpretimin ose mbrojtjen e legjislacionit lidhur me të drejtat e njeriut në një vend. Për shembull, NHRI-të mund të marrin në konsideratë mundësinë e ndërhyrjes në rastet kur GJEDNJ po shqyrton nëse një vendimmarrës publik ka respektuar legjislacionin për të drejtat e njeriut, dhe vendimi do të ndikojë në mënyrën e interpretimit të legjislacionit për të drejtat e njeriut në nivelin kombëtar.

## Udhëzime për një politikë gjyqësore strategjike

Një Politikë Strategjike e Procedurave Gjyqësore duhet të jetë mjaft e përgjithshme dhe të hartohet gjerësisht. Kjo politikë nuk është e nevojshme që të jetë përshkruese apo shteruese, dhe duhet t'i nënshtrohet rishikimit.

Çështja kryesore lidhet me përcaktimin nëse një çështje është strategjike, dhe nëse NHRI është organizata më e mirë pozicionuar për të ndërhyrë. Mundet që një tjetër organ publik apo një OJF të jetë më tepër i lidhur me çështjen, dhe rrjedhimisht më i përshtatshëm për të ndërhyrë. Disa nga faktorët që duhet të merren në konsideratë përfshihen në listën RAARO:

- **Rëndësia:** NHRI-të duhet të marrin në konsideratë funksionin e tyre gjyqësor strategjik në lidhje me:
  - Planin e tyre strategjik dhe prioritetet e punës - shkalla në të cilën çështja çon përpara detyrat dhe objektivat e NHRI-së në lidhje me fushëveprimin brenda mandatit të saj.

<sup>9</sup> [M.A. v. Denmark](#) (App. No. 6697/18)

<sup>10</sup> Shih Nenin 61 të Rregullave të Procedurave të GJEDNJ dhe Përmbledhjen e GJEDNJ mbi gjykimet pilot, e disponueshme në: [https://www.echr.coe.int/Documents/FS\\_Pilot\\_judgments\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/FS_Pilot_judgments_ENG.pdf)

- Rolet e tyre të tjera, të tilla si rritja e sensibilizimit - kur konsiderohet procesi gjyqësor strategjik, është e rëndësishme të merret parasysh ndërgjegjësimi i audiencës kombëtare dhe pozicioni ndaj çështjeve të çështjes në fjalë.
- **Përshtatshmëria:** a ka zgjidhje të tjera përvec Ndërhyrjes së Palës së Tretë në dispozicion dhe, a janë ato më të përshtatshme për të arritur të njëjtat synime? Për këtë ushtrim, duhet të merret parasysh detyra e NHRI-së për të vepruar në përputhje me misionin / vizionin e saj. Ndërhyrjet para GJEDNJ mund të jenë të përshtatshme, për shembull, kur advokimi i brendshëm nga NHRI ka qenë pa rezultat.
- **Vlera e shtuar - për çështjet individuale dhe ndryshimet sistematike:** përtej argumenteve të avancuara nga ndonjë prej palëve në çështje, deri në çfarë mase do të kishte vlerë në diskutimin pranë GJEDNJ për rastin specifik ndërhyrja e NHRI-së në cilësinë e palës së tretë, dhe në deri në çfarë mase gjykimi i GJEDNJ ka të ngjarë të çojë në ndryshim sistematik, përtej fakteve të çështjes. Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme të merren në konsideratë ndikimet tek aplikanti individual, si dhe pasojat e mundshme të padëshiruara.
- **Burimet:** shkalla në të cilën burimet e nevojshme për të çuar përpara çështjen do të jenë efektive dhe proporcionale me qëllimet dhe do të ndikojnë në aftësinë e NHRI-së për të marrë raste të tjera ose për t'iu përgjigjur çështjeve të reja të rëndësishme. Përtej çështjes së buxhetit, kjo është një çështje e lidhur me disponueshmërinë e stafit. Nënkontraktimi i firmave ligjore apo i avokatëve për shërbimet ligjore (pro bono) është një mundësi që NHRI mund të konsiderohet nga NHRI.
- **Palët e Treta të Tjera:** cila është gjasa që ndonjë palë tjetër të ndërhyjë? Nëse është kështu, NHRI mund të përpiqet të identifikojë vlerën e një ndërhyrje të mundshme të përbashkët. NHRI-të gjithashtu mund të konsiderojnë qasjen tek ndërhyrësit e mundshëm për të verifikuar fushën e përgjithshme dhe fokusin e ndërhyrjeve të tyre, çka më pas do të lejonin që NHRI të sigurojnë që ndërhyrja e tyre ka vlerë të shtuar dhe nuk kopjon atë të ndërhyrësve të tjerë.

### C. Rëndësia e ndërhyrjeve kolektive përmes ENNHRI

Ndërhyrjet kolektive nga ENNHRI para GJEDNJ kanë një rëndësi të veçantë sepse ato sjellin së bashku ekspertizën e NHRI nga i gjithë rajoni dhe mund të ofrojnë një pasqyrë krahasuese të praktikave të brendshme në të gjithë vendet anëtare të Këshillit të Evropës. Një përmbledhje e tillë është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur GJEDNJ po identifikon nëse ekziston një konsensus i dalë midis vendeve anëtare për çështjet e ligjit. Anasjelltas, përmbledhjet krahasuese gjithashtu mund t'i japin informacion GJEDNJ pse situata të caktuara kombëtare mund të jenë të jashtëzakonshme. Për rastet në të cilat praktika në vendin në fjalë është jashtë linjës me shumicën e vendeve të tjera evropiane, kontributet e specializuara të brendshme nga NHRI-të mund t'i sigurojnë GJEDNJ-së informacione të dobishme kontekstuale. Një ndërhyrje kolektive nga ENNHRI mund të jetë gjithashtu një opsion kur nuk është e

mundur që NHRI-të të ndërhyjnë mbi baza individuale, të tilla si, për shembull për shkak të kufizimeve të burimeve.

### **NHRI-të në Fokus: Ndërhyrja e ENNHRI si Palë e Tretë në GJEDNJ mundëson një përmbledhje krahasuese të praktikave kombëtare**

ENNHRI paraqiti parashtrimet në cilësinë e palës së tretë pranë GJEDNJ në çështjet *Strøbye* kundër Danimarkës dhe *Rosenlind* kundër Danimarkës<sup>11</sup> në lidhje me të drejtën e votës për individët që janë nën kujdestari ligjore ose të privuar nga zotësia juridike. Parashtrimi i cili u udhëhoq nga NHRI e Danimarkës (Insituti Danez për të Drejtat e Njeriut), nënvizoi se të drejtat e votës nuk mund hiqen vetëm bazuar në aftësinë e kufizuar.

Në të dyja rastet, aplikantët u kufizuan nga zotësia juridike sipas legjislacionit danez dhe për rrjedhojë nuk kishin të drejtë të votonin në zgjedhjet parlamentare kombëtare. Në parashtrimet e tij ENNHRI theksoi mospërputhjen e ligjit me standardet ndërkombëtare në nivelin e Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Evropës dhe prezantoi një përmbledhje krahasuese të legjislacionit dhe jurisprudencës përkatëse nga të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës, e cila tregoi një prirje drejt uljes së kufizimeve në të drejtën e votës për shtetas të vendosur nën kujdestari ose pa zotësi juridike. Siç tregohet në informacionin e siguruar nga 17 NHRI-të anëtare, që nga viti 2003, të paktën 15 Shtete Anëtare kanë ulur kufizime të tilla. Për më tepër, asnjë shtet anëtar nuk ka vendosur masa që synojnë kufizimin e mëtejshëm të së drejtës për të votuar për këtë grup në këtë periudhë.

Kjo paraqitje ishte rezultat i bashkëpunimit midis NHRI-ve Evropiane përmes Grupit të Punës për Çështjet Ligjore të ENNHRI si dhe Grupit të Punës për Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara<sup>12</sup>.

### **Politika e ndërhyrjes së palëve të treta sipas ENNHRI**

Grupi i Punës për Çështjet Ligjore të ENNHRI ka përpunuar një [Procedurë të Përbashkët](#) për paraqitjen e kërkesave për Ndërhyrje të Palëve të Treta përpara Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Kriteret për ndërhyrje janë që (1) Institucioni Kombëtar i të Drejtave të Njeriut (NHRI) i Shtetit të interesuar të mbështesë ndërhyrjen e ENNHRI, (2) të qënin një fushë prioritare lidhur me çështje sistemike të të drejtave të njeriut që dhe (3) një ndërhyrje mund të jetë e realizueshme dhe e përshtatshme, duke marrë marrë parasysh afatet e përcaktuara të GJEDNJ-së.

Kur monitorojnë rastet, për çdo herë anëtarët e ENNHRI do të marrin në konsideratë nëse një çështje që trajtohet, adreson një çështje sistemike të të drejtave të njeriut dhe nëse qëndron brenda fushave prioritare të ENNHRI. Kur një anëtar i ENNHRI vëren se këto kritere janë përmbushur, atëherë ai mund të hartojë një propozim që ndërhyrës si palë e tretë të jetë ENNHRI. Propozimi duhet të përmbajë rrethanat e faktit, një

<sup>11</sup> [Strøbye v. Denmark and Rosenlind v. Denmark](#) (Apps. Nos. 25802/18 and 27338/18)

<sup>12</sup> [ENNHRI submission](#) on *Strøbye v. Denmark and Rosenlind v. Denmark*

përmbledhje të ligjit, arsyet për propozimin e ndërhyrjes dhe një përmbledhje të asaj që do të mbulojë ndërhyrja.

Çështja nëse një Ndërhyrje e Palës së Tretë është "e realizueshme dhe e përshtatshme" lidhet me faktin nëse ENNHRI ka kapacitetin që brenda kohës që ka në dispozicion të realizojë një parashtrim në atë çështje duke pasur parasysh disponueshmërinë e anëtarëve për a) një analizë të parimeve përkatëse që mund të jenë të trajtuara nga ligji dhe nga praktika e vetë KEDNJ-së dhe / ose b) një analizë të tendencës për reforma legjislative lidhur me atë çështje në të gjithë Evropën në shtete të ndryshme.

Në varësi të fushave tematike në fjalë, Grupi i Punës për Çështjet Ligjore mund të bashkëpunojë dhe me grupe të tjera pune të ENNHRI, për të ndjekur fushën e tyre të ekspertizës, siç është bërë tashmë me Grupin e Punës për Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në rastet që kanë të bëjnë me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Kur propozohet një ndërhyrje në cilësinë e palës së tretë, NHRI që kryen propozimin, ftohet të marrë në konsideratë pyetjet si më poshtë vijon:

- A ka ndonjë vlerë të shtuar ndërhyrja nëpërmjet parashtrimeve kolektive të ENNHRI, krahasuar me qëndrimin e vetëm një NHRI?
- Cili është përfitimi për anëtarët e ENNHRI duke u paraqitur si Ndërhyrës në cilësinë e Palës së Tretë?
- Cili është rezultati / ndikimi që pritet nga paraqitja e një ndërhyrjeje në cilësinë e palës së tretë?
- A është ndërhyrja e palës së tretë mjeti / mënyra më e mirë për të arritur qëllimin?
- Cila është ekspertiza e anëtarëve të ENNHRI për çështjen në fjalë?
- Cila është disponueshmëria e anëtarëve të ENNHRI për të punuar në hartimin e parashtrimeve për ndërhyrjen?

Kur një çështje që është komunikuar, e monitoruar në shkallë kombëtare, trajton një ose më shumë nga fushat prioritare të ENNHRI me një çështje sistematike të të drejtave të njeriut, dhe kjo çështje duket së është e realizueshme dhe e përshtatshme, atëherë çdo anëtar mund të propozojë tek Kryetari i Grupit të tij të Punës, të ndërhyjë në çështje. Kryetari më pas do të konsultohet me të gjithë Grupin e Punës dhe me Kryetarin e Grupit të Punës për Çështjet Ligjore mbi këtë propozim. Në se do të dakordësohet për të vijuar, propozimi do t'i përcillet anëtarëve të ENNHRI ose, në rast emergjence i përcillet Bordit të ENNHRI.

## Si mund të ndërhyjnë NHRI-të në GJEDNJ?

### 3.1 Identifikimi i rasteve të përshtatshme

Faqja e internetit e GJEDNJ ([HUDOC](#)) publikon informacion në lidhje me çështjet, vendimet, praktikën gjyqësore dhe përditësime të tjera. Informacioni publikohet në një rënë ose në të dyja gjuhët e Gjykatës (anglisht dhe frëngjisht). Faqja e internetit është gjithashtu e aksesueshme në gjuhë të tjera (ruse, gjeorgjiane, spanjolle dhe turke) dhe praktika gjyqësore e GJEDNJ është përkthyer në shumë gjuhë të tjera. Sidoqoftë, numri i rasteve të përkthyer ndryshon shumë nga një gjuhë në tjetrën.

**Faqja e komunikimit të çështjeve HUDOC:** pasi pranohet marrja e një aplikimi, çështja i caktohet njërit prej pesë [seksioneve](#) të Gjykatës. Në këtë fazë, nëse çështja meriton shqyrtim të mëtejshëm nga Gjykata, Gjykata i komunikon Shtetit përkatës që kundër tij është paraqitur një kërkesë dhe fton Shtetin që të parashtrojë sa më pare shpjegimet. Më pas, në faqen e [HUDOC](#) bëhet publike një Deklaratë e Fakteve<sup>13</sup>. Gjithashtu, në faqen e internetit HUDOC mund të filtrohen çështjet (p.sh. për çdo shtet anëtar), siç tregohet në Figurën 1 të Aneksit.

Në mënyrë që të identifikohet çështja më strategjike për të ndërhyrë në cilësinë e palës së tretë, Palët e Treta duhet të kontrollojnë rregullisht faqen e çështjeve të komunikuar. Kjo është gjithashtu e nevojshme në funksion të periudhës së shkurtër 12-javore për të bërë kërkesë për të ndërhyrë, e cila në praktikë shpesh është më e shkurtër për shkak të publikimit të vonuar të çështjeve të komunikuar në HUDOC.

**Njoftime për shtyp:** Sekretari i Gjykatës publikon njoftime për shtyp për tema të ndryshme, përfshirë përmbledhjen e vendimeve, aktgjykimet, vendimet e ardhshme si dhe ndryshimet procedurale në Gjykatë. Njoftimet për shtyp të Gjykatës mund të aksesohen duke ndjekur [këtë link](#) ose përmes faqes së HUDOC, siç tregohet në Figurën 2 të Aneksit.

Me rëndësi për t'u theksuar janë edhe Njoftimet për Shtyp mbi vendimet e dhëna dhe ato që pritet të jepen lidhur me Referimet e Dhomës së Madhe<sup>14</sup>. Në figurën 3 të Aneksit ilustron shembulli i një njoftimi për shtyp mbi Vendimet e Dhomës së Madhe.

Siç shpjegohet edhe më poshtë, Palët e Treta zakonisht kanë afat 12 javë për të kërkuar leje për të ndërhyrë, nga data kur një çështje i është komunikuar Shtetit për observacione, ose nga koha kur vendimi i Dhomës është pranuar, ose kur ka një vendim për heqjen dorë nga juridiksioni në favor të Dhomës së Madhe.

Gjykata gjithashtu informon publikun në njoftimet për shtyp lidhur me çështjet për të

<sup>13</sup> Deklarata e Fakteve është një përmbledhje e shkurtër e rrethanave të faktit të parashtruar para Gjykatës nga aplikanti, përfshirë nenin ose nenet e Konventës që pretendohet se janë shkelur. Për më tepër informacion, referojuni pikës 4.

<sup>14</sup> Sipas nenit 43 të KEDNJ, çdo palë në raste të veçanta dhe brenda 3 muajsh nga data e gjykimin në Dhomë, mund të kërkohet që çështja të referohet pranë Dhomës së Madhe të Gjykatës me 17 anëtarë. Vendimi mbi kërkesën për referim merret nga një panel prej 5 gjyqtarësh. Gjithsesi, rastet e pranimit të këtyre kërkesave janë tepër të rralla.

cilat është hequr dorë nga Dhoma e Madhe<sup>15</sup>. Njoftimet për shtyp të Gjykatës për këto çështje mund të gjenden në këtë [link](#) ose në faqen e HUDOC, siç tregohet në Figurën 4 të Aneksit. Në raste të tilla, Palët e Treta zakonisht kanë afat 12 javë nga data kur për një çështje hiqet dorë nga Dhoma e Madhe, për të kërkuar leje për të ndërhyrë.

**Burime të tjera:** Për të qenë të vetëdijshëm mbi përditësimet dhe lajmet e fundit të Gjykatës, Palët e Treta gjithashtu mund të kontrollojnë rregullisht informacionin e ndarë përmes llogarisë së GJEDNJ në [Twitter](#). Përveç informacionit të bërë publik në dispozicion nga Gjykata, Palët e Treta mund të marrin në konsideratë kontaktimin e avokatëve drejtpërdrejtë dhe burime jo të-GJEDNJ (të tilla si përfaqësuesit ligjorë të palëve, OJQ-të dhe çdo organizatë tjetër që mund të ketë më shumë informacion mbi çështjet e trajtuara para Gjykatë). Sidoqoftë, veçanërisht në komunikohet me përfaqësuesit ligjorë të palëve, është e rëndësishme që Palët e Treta të respektojnë parimin e neutralitetit.

## 3.2 Kërkesa për leje (Rregulli 44)

### Koha (12 javë)

Shprehja “*kërkesë për leje*” i referohet veprimit të kërimit të GJEDNJ-së për leje për të ndërhyrë në procedurë si një palë e jashtme neutrale, e quajtur si një Palë e Tretë. Rregullat e Gjykatës përcaktojnë një periudhë 12 javore për të kërkuar leje nga Dhoma ose Dhoma e Madhe, duke filluar nga njoftimi për palët (“komunikimi”) i çështjes, ose vendimi i Dhomës për të pranuar kërkesën<sup>16</sup> ose vendimin për heqjen dorë nga juridiksioni<sup>17</sup> në favor të Dhomës së Madhe. Në praktikë, kjo periudhë është edhe më e shkurtër pasi Deklarata e Fakteve nuk bëhet e disponueshme për publikun në internet deri në ca kohë, madje me javë të tëra, pas ditës së komunikimit.

Për shembull, nëse një çështje u njoftohet palëve në 8 janar 2019, palët e treta do të kenë si rregull 12 javë kohë për të kërkuar leje për të ndërhyrë - domethënë, deri më 2 Prill 2019.

Afatet mund të **shkurtohen**, veçanërisht në rastin e çështjeve urgjente, ose kur palëve u janë dhënë afate më të shkurtra.

---

<sup>15</sup> “Kur një çështje e cila është në pritje në Dhomën e Madhe lidhet me një problematikë që ndikon në interpretimin e Konventës ose të Protokolleve të Saj, Dhoma mund të heqë dorë nga juridiksioni në favor të Dhomës së Madhe, përveç se në rastin kur një prej palëve ka kundërshtuar në përputhje me Paragrafin 4 të këtij Rregulli.” Shiko rregullin 72 të Rregullores së Gjykatës.

<sup>16</sup> Referimi dhe heqja dorë janë dy mekanizma nëpërmjet të cilëve rastet kalohen nga Dhomat në Dhomën e Madhe. Një rast mund të referohet në Dhomën e Madhe për rivlerësim me kërkesë nga secila prej palëve, pasi është dhënë vendimi nga Dhoma. Këto aplikime për referimin e rasteve gjykohen nga një panel me 5 gjyqtarë, i cil vendos nëse ekzistojnë mjaftueshëm çështje “serioze” për të mbledhur Dhomën e Madhe. Procesi dhe parimet në të cilat bazohet vendimmarrja e këtij paneli është e paqartë dhe rastet e suksesit në këto referime janë shumë të pakta.

<sup>17</sup> Rastet gjithashtu dërgohen në Dhomën e Madhe kur nuk pranohen nga Dhoma, megjithëse edhe ky është rast përjashtimor. Dhoma të cilës i është caktuar një rast mund të heqë dorë nga ky i fundit për t’a kaluar në Dhomën e Madhe, nëse rasti paraqet një çështje serioze që ndikon në interpretimin e Konventës ose nëse ekziston risku i mospërputhjes me një gjykim të mëparshëm të Gjykatës. Për më tepër informacion, mund të konsultoheni në këtë [link](#).

Në rast referimi ose heqje dorë, leja mund të **refuzohet** kur "kërkohej shumë afër seancës dëgjimore". Për shembull, në çështjet e Dhomës së Madhe seancat në përgjithësi zhvillohen brenda 4-5 muajve nga referimi ose heqja dorë, dhe dosja e çështjes duhet të jetë gati një muaj para se të zhvillohet seanca dëgjimore (përkthimi i dokumenteve, kopjeve, koha e leximit, etj.). .

Gjykata është zakonisht shumë strikte me respektimin e afateve, veçanërisht në lidhje me çështjet e Dhomës së Madhe, megjithatë afatet mund të **zgjaten** nëse Pala e Tretë kontakton sekretariatit dhe jep arsye shumë bindëse se përse është e nevojshme zgjatja e këtij afati. Kjo mund të konsiderohet e justifikueshme, për shembull, kur ndërhyrësi i mundshëm nuk ka qënë informuar për rastin në një fazë më të hershme për shkak të rrethanave që kanë qënë jashtë kontrollit të tij.

Vendimi për të shkurtuar ose zgjatur afatin e kërkesës së lejes për të ndërhyrë është në diskrecion të Kryetarit të Dhomës përkatëse. Prandaj, palët e treta inkurajohen të presin një afat prej 12 javësh përveç nëse përcaktohet ndryshe nga sekretari. Në rast se kanë dyshime lidhur me afatin për të kërkuar leje për të ndërhyrë, Palët duhet të kontaktojnë sekretarinë.

#### **RREGULLI 44, 1 (b)**

Nëse një Palë Kontraktuese dëshiron të ushtrojë të drejtën e saj sipas Nenit 36 § 1 të Konventës për të paraqitur komente me shkrim ose për të marrë pjesë në një seancë dëgjimore, do të duhet të njoftojë Sekretarinë me shkrim jo më vonë se dymbëdhjetë javë pas transmetimit ose njoftimit të përmendur në nënparagrafin paraardhës. Për arsye të jashtëzakonëshme mund të caktohet një afat tjetër kohor nga Kryetari i Dhomës.

#### **RREGULLI 44, 4**

(a) Në rastet që do të merren parasysh nga Dhoma e Madhe, periudhat kohore të parashikuara në paragrafët e mësipërm do të fillojnë nga momenti i njoftimit të palëve për vendimin e Dhomës sipas Rregullit 72 § 1 për heqjen dorë nga juridiksioni në favor të Dhomës së Madhe ose të vendimit të panelit të Dhomës së Madhe sipas Rregullit 73§ 2 për të pranuar një kërkesë nga një palë mbi referimin e çështjes në Dhomën e Madhe.

(b) Afatet e përcaktuara në këtë Rregull përjashtimisht mund të zgjaten nga Kryetari i Dhomës nëse ka një shkak mjaftueshëm të justifikuar.

#### **Elementet thelbësore të kërkesave për leje**

Kërkesat për leje për të ndërhyrë duhet të jenë të shkurtra dhe koncize, në anglisht ose frëngjisht, dhe jo më shumë se 2-3 faqe duk përfshirë elementët si më poshtë:

- Prezantimi i Palës së Tretë, qëllimet dhe aktivitetet e saj
- Interesi i Palës së Tretë në çështje
- Të dhëna të veçanta se si Pala e Tretë synon të kontribuojë në çështjen konkrete dhe si ndikon në interesin më të mirë të administrimit të drejtësisë
- Kur Pala e Tretë ka ndërhyrë në raste të tjera më parë, rekomandohet të përmenden ndërhyrjet e mëparshme, megjithëse kjo nuk është e detyrueshme,



sepse Gjykata ka më shumë të ngjarë të bashkëpunojë me një palë me të cilën kanë punuar më parë

Pëlqimi nga palët e çështjes nuk është i nevojshëm, megjithatë Pala e Tretë mund të konsiderojë nëse është strategjikisht e dobishme për aplikimin e saj që të njoftojë palët e çështjes. Kur kontakton me palët e përfshira në çështje, Pala e Tretë duhet të kufizojë komunikimin e saj dhe duhet të respektojë parimin e neutralitetit midis palëve. Mosrespektimi i parimit të neutralitetit mund të ndikojë në refuzimin e përfshirjes në çështje nga ana e Gjykatës.

### **RREGULLI 44, 3 (b)**

Kërkesat për leje për këtë qëllim duhet të jenë **të arsyetuara siç duhet** dhe të paraqiten **me shkrim** në njërën nga **gjuhët zyrtare** siç parashikohet në rregullin 34 § 4 jo më vonë se dymbëdhjetë javë pasi njoftimi i kërkesës t'i jetë dhënë Palës së paditur. Për arsye të jashtëzakonshme mund të caktohet nga Kryetari i Dhomës një afat tjetër kohor.

#### **Miratimi dhe arsyet e refuzimit**

Vendimi për të pranuar ose refuzuar kërkesën merret nga Kryetari i Dhomës ose nga Dhoma e Madhe, si rregull bazuar në rekomandimin e një Gjyqtari raportues<sup>18</sup>. Gjykata përgjithësisht ndjek një politikë liberale: shumica e kërkesave pranohen, por kjo nuk është absolute. Ekzistojnë dy arsye për refuzim:

1. Kur kërkesa është paraqitur jashtë afatit kohor;
2. Kërkesa nuk është në interes të administrimit të duhur të drejtësisë, përfshirë rastet e mungesës së neutralitetit ose kur rëndësia e ndërhyrjes në çështjen konkrete nuk është thelbësore.

Gjykata zakonisht vendos për kërkesën brenda 3-4 javësh, megjithatë mund të presë dhe deri në fund të periudhës 12-javore në rast se pret të marrë shumë kërkesa (shpesh në raste që lidhen me çështje shoqërore, etike ose fetare) në mënyrë që të zgjedhë aplikantët më të mirë nga grupi i ndërhyrjeve të mundëshme.

### **3.3 Udhëzime për mënyrën e të shkruarit të ndërhyrjes së Palës së Tretë**

#### **Drejtimit kryesore të ndërhyrjes**

Sapo të merret kërkesa e palës së tretë për përfshirje, Sekretari i Gjykatës mund të përgjigjet me një konfirmim për marrjen e kësaj kërkesë, pavarësisht se tanimë kjo praktikë është gjithnjë e më në zbehje. Ndonëse nuk ka një rregull për rastet kur sekretari informon palët e treta në lidhje me vendimin për dhënien ose refuzimin e lejes për të ndërhyrë, palët e treta mund të presin që të marrin përgjigje brenda 2-4 javësh, përveçse nëse informohen ndryshe nga sekretari.

Kur leja aprovohet, Gjykata zakonisht vendos udhëzimet vijuese kryesore në lidhje me ndërhyrjen e palës së tretë:

<sup>18</sup> Kreu III i Rregullores së Gjykatës

- **Gjatësia:** maksimumi dhjetë faqe të shtypura. Nuk ka asnjë kufizim për anekset, por Palët e Treta këshillohen të jenë të arsyeshme dhe të mbajnë në vëmendje mbledhjen e të dhënave më të rëndësishme në ndërhyrje. Sëbashku me kërkesën për ndërhyrje mund të dorëzohet dhe një kërkesë për një ndërhyrje më të gjatë. Leja varet nga çështja, por asnjë Palë e Tretë nuk duhet të paraqesë para Gjykatës një ndërhyrje të gjatë pa njoftim paraprak.
- **Kufizimet kohore:** Gjykata zakonisht kërkon një periudhë kohe 3 javore për paraqitjen e duhur të ndërhyrjes. Gjykata mund të kërkojë një afat të ndryshëm pasi të ketë marrë parasysh vërejtjet e palëve. Sidoqoftë, zgjatjet e afatit nuk janë të shpeshta në praktikë, veçanërisht në çështjet e Dhomës së Madhe.
- **Përmbajtja:** Gjykata shpesh përsërit se ndërhyrjet mund të mos shprehen për fakte të veçanta ose për pranueshmërinë e çështjes.

### Aplikimi dhe materialet

Në praktikë, Palët e Treta i mbështesin ndërhyrjet e tyre në informacionin e disponueshëm në Deklaratën e Fakteve, i cili shpeshherë është i pakët. Kur analizojnë Deklaratën e Fakteve, palët e treta mund të konsiderojnë t'i kushtojnë vëmendje elementeve të mëposhtme:

- **Nenet e KEDNJ-së për** të cilat kërkuesi pretendon se ka shkelje (p.sh. Neni 8 i KEDNJ-së; neni 13 i KEDNJ-së në lidhje me nenin 3 të KEDNJ-së, etj.)
- Natyra e kërkesës së aplikantit dhe **subjekti në fjalë** (p.sh. mungesa e qasjes për trajtim të përshtatshëm mjekësor; rreziku i keqtrajtimit nëse kthehet në vendin e origjinës, etj.)
- **Pyetjet për Palët**, të cilat mund të pasqyrojnë pikat kryesore që Gjykata do të analizojë në vendimin e saj përfundimtar (p.sh. "A do të përballej kërkuesi me një rrezik real të shkeljes flagrante të Nenit 8 nëse urdhri i dëbimit do të zbatohet?").
- **Datat përkatëse** në lidhje me ankesat e kërkuetit (p.sh. periudha e ndalimit të kërkuetit, datat e vendimeve përkatëse të gjykatës kombëtare, etj.)
- **Një praktikë tjetër gjyqësore** e përmendur në Deklaratën e Fakteve, e cila mund të ilustrojë jurisprudencën përkatëse të GJEDNJ që duhet të mbahet në vëmendje;

Në Figurën 5 të Ankesit ilustron një shembull i një Deklarate të Fakteve. Palët e treta mund të kërkojnë dokumentacion shtesë<sup>19</sup>, për shembull kopje të observacioneve të palëve mbi pranueshmërinë ose kur është e zbatueshme, mund të kërkojnë komente me shkrim të ndërhyrësve të tjerë<sup>20</sup>. Sidoqoftë, Gjykata ka një qasje kufizuese ndaj ndërhyrësve përse i përket dërgimit vetëm të dokumenteve që do t'i lejojnë ata të pregatisin parashtrimet e tyre dhe jo tërësinë e dokumentacionit të shkëmbyer midis palëve në procedurë. Në çdo rast, të gjitha materialet e paraqitura nga palët, përveç nëse janë konfidenciale, janë publike dhe mund të konsultohen.

<sup>19</sup> Për më tepër informacion lidhur me aksesin në dokumentacionin e çështjeve referojuni materialit "Çështje praktike lidhur me aksesin në dokumentacionin e çështjeve, [këtu](#). Kërkesat për leje për konsultimin e dosjeve mund të bëhen duke përdorur [formularin online](#).

<sup>20</sup> Neni 40(2) i KEDNJ parashikon që dokumentat e depozituar në Sekretari janë të aksesueshme për publikun, përveç rastit kur Kryetari i Gjykatës vendos ndryshe. ëë

## Gjuha

Ndërhyrja duhet të jetë e shkruar në gjuhën angleze ose atë frënge. Për të paraqitur ndërhyrjen në një gjuhë tjetër zyrtare të një Shteti Anëtar nevojitet leja e kryetarit, megjithatë edhe në këtë rast nevojitet përkthimi në anglisht ose frengjisht. Në rastet e çështjeve që shqyrtohen në Dhomën e Madhe është e këshillueshme që palët t'i përmbahen gjuhës angleze ose franceze.

Nuk është i nevojshëm përkthimi i anekseve.

## Përmbajtja

**Lloji i informacionit të dobishëm për Gjykatën përcaktohet në varësi të qasjes që pala e tretë do të zgjedhë për ndërhyrjen:**

- **Informacion mbi interpretimin e normave ndërkombëtare nga juridiksione të tjera:** një ndërhyrje e palës së tretë mund të zbulojë sesi juridiksione të tjera interpretojnë norma të caktuara ndërkombëtare. Sa kohë që Gjykata nuk është e detyruar të zbatojë interpretime gjykatave të tjera rajonale ose ndërkombëtare, ndërhyrja e palës së tretë mund të udhëzojë Gjykatën për ekzistencën e një interpretimi mbizotërues të një pike të caktuar të ligjit (p.sh. duke iu referuar jurisprudencës së gjykatave të tjera ndërkombëtare, të tilla si Gjykata Ndër-Amerikane e të Drejtave të Njeriut) ose të informojë GJEDNJ për detyrimet e tjera ligjore të Shtetit Palë në fjalë (për shembull, sipas ligjit të BE).
- **Informacion përmes të drejtës së krahasuar:** një ndërhyrje e palës së tretë mund të demonstrojë ndryshimet dhe ngjashmëritë midis sistemeve ligjore (dhe praktikave) të vendeve të ndryshme.
- **Informacion mbi ligjin dhe praktikën në nivelin kombëtar:** ndërhyrja mund të tregojë praktikën në nivelin kombëtar për të siguruar informacion bazë që do të lehtësojë interpretimin e Gjykatës. Për shembull, detaje lidhur me origjinën e ligjeve të caktuara, historinë e hartimit të ligjit dhe mënyrën se si ligji zbatohet dhe interpretohet brenda vendit. Kjo qasje mund të ndihmojë gjithashtu Gjykatën për të identifikuar çështje sistematike në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Shtetin Palë në fjalë.
- **Informacion mbi të dhënat përkatëse, statistikat dhe situatën në terren:** pala e tretë mund të ketë njohuri të specializuara në lidhje me të dhënat ose informacionin statistikor mbi situatën aktuale në terren ose përhapjen e tendence a problemi të veçantë.  
Për shembull, sigurimi i informacionit për vendin e origjinës në rastet e dëbimit (UNHCR është një ndërhyrës i shpeshtë). Një palë e tretë gjithashtu mund të përmbledhë raportet e gjetjes së fakteve që mund të jenë të rëndësishme për çështjen (për shembull, për kushtet e paraburgimit në mjediset ku ishte ndaluar një aplikant).
- **Informacion mbi jurisprudencën e GJEDNJ:** një ndërhyrje e palës së tretë mund të deklarojë se cila është praktika gjyqësore e GJEDNJ për një temë specifike. Sidoqoftë, pala e tretë duhet të shmangë shprehjen e pikëpamjeve të saj mbi GJEDNJ (shih rubrikën "Të bëhet dhe të mos bëhet" më poshtë). Nëse ndërhyrja vlerësohet se nuk përputhet me kushtet dhe kufizimet e vendosura në autorizimin nga Kryetari, ai mund të vendosë të mos përfshijë komentet e shkruara të ndërhyrësit në dokumentat e çështjes (Rregulli 44 § 5)

ose nëse është e përshtatshme, udhëzon ndërhyrësin të paraqesë komente të reja me shkrim që janë në përputhen me to.

## Ndërhyrjet e palëve të treta: “Ç’duhet bërë dhe ç’duhet evituar”

### Ç’duhet bërë

- **Kufizimi i shprehjes së mendimit në situatën e përgjithshme të çështjes** (“Sipas mendimit të Komisionerit, pjesëmarrja e plotë e personave me aftësi të kufizuara intelektuale dhe psikosociale në jetën politike dhe publike mund të fillojë një rreth virtuoze...”).
- **Të tregohet nga afër burimi i të dhënave** dhe statistikave të përmendura në ndërhyrje. Të përfshihet referenca përkatëse e botimeve, raporteve dhe dokumenteve të tjera përkatëse me shënime në fund të faqes.
- **Të qëndruarit neutral dhe shmangia ndaj të qenit tepër “aktivist”** (“Gjykata ka mundësinë për të forcuar të drejtat e këtij grupi duke vendosur që...”, “Ne e nxisim Gjykatën të mbrojë të drejtat e”, “Ne besojmë se kërkuesi është i saktë kur pohon se...”).
- **Të qenit objektiv** (“Në jurisprudencën e saj për këtë çështje, kjo Gjykatë vendosi që...”, “Shtetet Kontraktuese kanë detyrime pozitive sipas Konventës ndaj...”).

### Ç’duhet evituar

- **Përdormi i gjuhës subjektive** (“Ne besojmë se ky Nen duhet të interpretohet në këtë mënyrë”, “Ne jemi shumë të shqetësuar për situatën e aplikantit”).
- **Argumentimi i çështjes specifike duke komentuar faktet e çështjes** (“Argumenti i qeverisë është i gabuar sepse...”, “Të drejtat e kërkuesit u shkelën kur ai / ajo...”). Në vend të kësaj, një ndërhyrje duhet të përqendrohet në çështjet e përgjithshme të ngritura në ankesë, bazuar në përvojën ose ekspertizën e vetë palës së tretë.
- **Analizimi ose shprehja e tepruar e pikëpamjeve mbi praktikën gjyqësore të GJEDNJ**: ndërsa një palë e tretë mund të deklarojë atë që vendosi GJEDNJ (“Në FG kundër Suedisë, Dhoma e Madhe vendosi që autoritetet duhet...”), ndërhyrësit duhet të shmangin shprehjen e pikëpamjeve të tyre mbi çështjen - (“Me të drejtë, aktgjykimi i Dhomës krahason...”, “Nëse kjo Gjykatë do të gjykonte në këtë mënyrë, kjo do të ishte në kontrast me çështjen X”). Ata mund ta bëjnë këtë vetëm nëse janë formuluar me kujdes, për shembull për të shpjeguar pse praktika gjyqësore duhet të çojë në një interpretim të caktuar, ose për të sugjeruar një zhvillim të mëtejshëm në interpretim.
- **Shprehja e mendimit mbi rezultatin e çështjes** (“Sipas mendimit tonë, Dhoma e Madhe duhet të mbështesë aktgjykimin...”, “Ne besojmë se Gjykata duhet të konstatojë se kjo shkel të drejtën e kërkuesit për...”).

## Përdorimi i Ndërhyrjeve të Palëve të Treta në raste të tjera

Informacioni i siguruar nga një Palë e Tretë nuk përdoret automatikisht për raste të tjera. Ndërhyrja dhe parashtrimet bëhen pjesë e dosjes për rastin e veçantë për të cilin janë përpiluar. Nëse komunikohet një rast i ngjashëm, pala e tretë këshillohet të marrë në konsideratë kërkimin e lejes së Gjykatës për të përfshirë ndërhyrjen në dosjen e çështjes tjetër të ngjashme.

### 3.4 Komunikimi me Sekretarin e Gjykatës

Palët e treta duhet të përdorin detajet e mëposhtme të kontaktit kur komunikojnë me Sekretarin e Gjykatës. Palët e treta këshillohen të paraqesin kërkesa për leje për të ndërhyrë dhe nëpërmjet faksit ose me postë. Preferohet dërgimi i dokumenteve me letër të regjistruar. Sugjerohet referimi gjithmonë në faqen në internet të Gjykatës për mënyrën më të përditësuar dhe të përshtatshme të komunikimit me të.

Kur dorëzohen dokumente në regjistër, palët e treta këshillohen të tregojnë qartë detajet e kontakteve të tyre. Përveç adresës dhe numrit të faksit, Palët e Treta mund të tregojnë gjithashtu një adresë email për të lehtësuar komunikimin me Sekretarinë.

Nr. Fax:                   +33 (0)3 90 21 43 10 (numër i përkohëshëm)  
                              +33 (0)3 88 41 27 30 (numër fiks)

Adresa:                   TheRegistrar  
                              European Court of Human  
Rights  
                              Council of Europe  
                              F-67075  
                              Strasbourg France

## Pas paraqitjes së kërkesës për ndërhyrje të Palës së Tretë

Pas paraqitjes së kërkesës për ndërhyrje, Pala e Tretë duhet të presë derisa Gjykata të vendosë për çështjen. Është e pamundur të vlerësohet sësia kohë do t'i duhet Gjykatës që të vendosë për një çështje specifike. Pasi GJEDNJ të marrë vendim për çështjen në të cilën Pala e Tretë ka ndërhyrë, Pala e Tretë rekomandohet të kryejë një analizë të hollësishme të vendimit të Gjykatës jo vetëm duke vlerësuar drejtimin e marrë nga Gjykata në çështjen konkrete, por gjithashtu për të identifikuar dhe si Gjykata i referohet ose ndjek pikëpamjet e Palës, siç parashtrohen në ndërhyrje. Pala e Tretë gjithashtu mund të zgjedhë të kombinojë ndërhyrjen e saj me veprimet në nivel kombëtar, veçanërisht kur vendimi i Gjykatës konsiderohet pozitiv.

Gjithashtu është e rëndësishme të theksohet se një vendim i GJEDNJ nuk është një qëllim në vetvete. Shtetet Anëtare të Këshillit të Europës, kanë një detyrim ligjor për të zbatuar plotësisht vendimet e GJEDNJ-së në nivel kombëtar. NHRI-të mund të këshillojnë shtetet në identifikimin se si vendimi i GJEDNJ-së mund të zbatohet në mënyrë efektive në nivelin kombëtar.

Një nga mënyrat sipas të cilave Palët e Treta mund të përfshihen në zbatimin e vendimeve të GJEDNJ-së në nivelin kombëtar është përmes të ashtuquajturit "proces i ekzekutimit të vendimit". ENNHRI ka publikuar një Udhëzim për Institucionet Kombëtare të Drejtave të Njeriut për të mbështetur Zbatimin e Vendimeve nga Gjykata Evropiane e Drejtave të Njeriut<sup>21</sup>, i cili është i disponueshëm [këtu](#).

### **NHRI-të në fokus: Institucioni Kombëtar i të Drejtave të Njeriut në Francë (CNCDH) paraqet ndërhyrje në cilësinë e palës së tretë mbi kushtet e pritjes**

NHRI Franceze, (CNCDH), paraqiti një Ndërhyrje të Palës së Tretë në GJEDNJ në çështjen Khan kundër Francës<sup>21</sup>. Parashtrimi i NHRI kishte të bënte me cenueshmërinë e të miturve të huaj të pashoqëruar në Calais, duke theksuar dështimin e shtetit të Francës për t'i mbrojtur ata gjatë periudhës 2015-2016.

GJEDNJ vendosi që dështimi i autoriteteve franceze për të siguruar kujdesin për një të mitur të huaj të pashoqëruar në kampin Calais përbënte një shkelje të nenit 3 të KEDNJ. Në gjykim, Gjykata u mbështet pjesërisht në vëzhgimet e CNCDH për të pranuar një shkelje të Nenit 3.

Në përputhje me Deklaratën e Brukselit për zbatimin e KEDNJ-së, Ministria e Punëve të Jashtme i referoi çështjen CNCDH për vëzhgimet e saj mbi masat për zbatimin e këtij gjykimi.

CNCDH më vonë paraqiti një komunikim në Komitetin e Ministrave në zbatim të e Rregullit 9, i cili u botua së bashku me përgjigjen e autoriteteve të korrikut 2019. Një plan veprimi ose raport mbi çështjen pritet nga autoritetet.

<sup>21</sup> [Khan v. France](#) (App. No. 12267/16)

Shenim:

**Ky është një përkthim jozyrtar. Ju lutemi, shihni edhe tekstin origjinal.** *Third Party Interventions Before the European Court of Human Rights – Guide for National Human Rights Institutions.*

<http://ennhri.org/news-and-blog/new-nhri-guide-on-third-party-interventions-before-the-european-court-of-human-rights/>